



Prishtinë: 01.10.2012

Kodi i ZRRE-së: V\_439\_2012

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_R\_837\_08\_12

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_R\_837\_08\_12**;

Në mbledhjen e mbajtur më 01 tetor 2012 nxori këtë:

### VENDIM

**REFUZOHET** ankesa e konsumatorit I. H, Shpk. "A", (shifra DPR – 90060625), nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 14.06.2012 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 28.05.2012 lidhur me kontestimin e faturës 03/2012.

- Me datë 07.04.2012 KEK-u i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për muajin 003/2012 me 39784.15 kWh apo e shprehur në vlerë financiare 4,045.50 €.  
**Provë:** Fatura e energjisë elektrike e muajit 03/2012
- Pas arritjes së faturës së muajit 03/2012 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për konsumator në KEK duke kundërshtuar faturën e muajit 03/2012.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit
- Me datë 28.05.2012 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në leximin e bërë me datë 01.04.2012.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 28.05.2012
- Me datë 14.06.2012, konsumatori ka apeluar përgjigjur e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

ZRRE, duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEK-ut, ka vërejtur se:

- ✓ KEK-u për llogaritjen e faturës së muajit mars 2012 ka marr për bazë gjendjen reale të kilovatëve të shpenzuar e të regjistruar në procesin e leximit të periudhës 03/2012 përkatësisht me datë 01.04.2012, ku gjendja në tarifën e lartë është 6104.79 kWh, tarifa e ulët 215.06 kWh, energjia reaktive në tarifën e lartë R\_T1 është 3638.22 kVArh, energjia reaktive në tarifën e ulët R-T2 është 104.48 kVArh dhe fuqia maksimale e angazhuar Pmax=3.09 kW, e që në total e shprehur në vlerë financiare KEK-u e ka faturuar me 4,045.50 €.
- ✓ Bazuar në analizën e përgjithshme të rrjedhës së energjisë elektrike konstatohet se konsumatori ka lexim të rregullt të shpenzimeve mujore të energjisë elektrike dhe se në



asnjë rast nuk është faturuar pa matje/paushall, por që KEK sha ka faturuar shpenzimet reale mujore të konsumatorit. KEK-u po ashtu ka ofruar edhe proceset e leximit për njehsorin elektrik nr. 96256467 me të cilat vërtetohet se njehsori elektrik i konsumatorit është lexuar brenda periudhave të përcaktuara kohore të leximit duke përdorur pajisjen AMR apo leximin në distancë.

**Provë:** Rrjedha e energjisë elektrike

- ✓ DMK ka analizuar proceset e leximit për njehsorin elektrik nr. 96256467 prej periudhës 08/2011 deri më 05/2012 dhe konstaton se të gjitha të dhënat e regjistruara për shpenzimet e regjistruara në njehsorin elektrik janë të njëjta me ato në rrjedhën e energjisë elektrike ku si rrjedhojë faturimi mujor i energjisë së shpenzuar nga konsumatori është i saktë.

**Provë:** Proceset e leximit për njehsorin elektrik nr. 96256467 prej periudhës 08/2011 deri më 05/2012

- ✓ DMK ka analizuar faturën e periudhës 03/2012 numër 03120DPR-90060625 të datës 07.04.2012 dhe konstaton se Departamenti i faturimit në KEK ka faturuar shpenzimet reale të konsumatorit të krijuara për periudhën 03/2012 sipas tarifave të aprovuara nga ZRRE për konsumatorët e grupit tarifor 3.

**Provë:** Fatura numër 03120DPR-90060625 e datës 07.04.2012

- ✓ Konsumatori në deklaratën e tij thekson se dyshon në mos leximin e saktë të njehsorit elektrik pasi që për periudhën e njëjtë një vit më herët fatura për energji elektrike ka qenë 1,099.98€, ndërsa për periudhën paraprake përkatësisht periudha 02/2012 ka qenë 2,174€ e që dallimi është 1,870€ edhe përkundër asaj që nuk është rritur kapaciteti i prodhimit në fabrikë si dhe nuk janë shtuar turne.

**Provë:** Deklarata e konsumatorit

DMK, duke u bazuar në analizat dhe argumentet e paraqitura më lartë, rekomandon Bordin e ZRRE-së, që të **refuzojë** ankesën e konsumatorit si të pabazë.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet dhe argumentet e paraqitura dhe pas analizës së lëndës së konsumatorit ka vendosur që të **refuzojë** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, Kryesues i Bordit

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtar

---

Krenar Bujupi, anëtar